



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 946/2 Prot.

Tiranë, më 11.11.2021

V E N D I M

Nr.141, datë 11.11.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës disiplinore përfunduar me masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vjeçare”, të Komisionit të Disiplinës, për nëpunësin ***, me detyrë “Specialist në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimin e Mbetjeve”, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa pretendime për parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në procesin administrativ, që ka përfunduar me dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vjeçare”, të paraqitur nga nëpunësi ***** , me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve

për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimin e Mbetjeve, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit,

Vërej se:

Nëpunësi civil *****, nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 946 prot., datë 27.09.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera ose të lejuara në procesin administrativ, në lidhje me marrjen ndaj tij të masës disiplinore “Shkelje e rëndë”, nga ana e Komisionit të Disiplinës, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua materiali shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësit, si dhe dokumentacioni sqarues i dërguar nga institucioni Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me e-mail, të datës 06.10.2021, prej nga ka rezultuar sa më poshte:

Nëpunësi ***** është nëpunës civil në pozicionin “Specialist në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimin e Mbetjeve”, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil nr. 5447/2 prot., datë 05.03.2013), për rrjedhojë, bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ligjshmërisë së një procedure administrative, përfshihet në juridiksionin e çështjeve që mbikëqyren prej Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Kërkesa e paraqitur përmban pretendime në lidhje me ligjshmërinë e zhvillimit të një ecurie disiplinore ndaj tij, proces i cili është përmbyllur me vendim të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Nr. 3936/14 prot., datë 20.09.2021 për dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vjeçare”.

Pas kërkesës për tu njohur me dokumentacionin që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procedimi disiplinor, Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka vënë në dispozicion dokumentat e mëposhtme:

- Akti nr. 3936 prot., datë 08.06.2021, “Kërkesë për nisje të ecurisë disiplinore ndaj *****”, të Drejtorit të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit;

- *Akti nr. 3936/1 prot., datë 15.06.2021, “Njoftim për fillim të ecurisë disiplinore për *****”, të Drejtorit të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit;*
- *Urdhër nr. 149, datë 17.06.2021, (nr. 3936/2 prot., datë 17.06.2021) “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”, të Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Aktin nr.3936/3 prot., datë 17.06.2021, “ Kërkesë për caktim të anëtarit nga DAP në Komisionin e Disiplinës”, të Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Procesverbali i seancës dëgjimore nr.30/6, datë 30.06.2021, të Komisionit të Disiplinës;*
- *Aktin nr.3936/4 prot., datë 21.06.2021, “Observacion ndaj shkresës nr.3936/1 prot., datë 15.06.2021, “Njoftim për fillim të ecurisë disiplinore” për *****” të ankuesit;*
- *Aktin nr. 3936/5 prot., datë 22.06.2021, “Njoftim për shtyrjen e seancës mbi ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit *****”, të Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Procesverbali i seancës dëgjimore datë 30.06.2021, të Komisionit të Disiplinës;*
- *Aktin nr. 3936/6 prot, datë 06.07.2021, “Informacione shtesë, të nevojshme për ecurinë disiplinore ndaj *****”, të Drejtorit të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit;*
- *Aktin nr. 3936/7 prot, datë 08.07.2021, “Kthim përgjigje shkresës nr. 3936/6 prot, datë 06.07.2021, “Informacione shtesë, të nevojshme për ecurinë disiplinore ndaj *****” të ankuesit;*
- *Aktin nr. 3936/8 prot, datë “Dërgohet dokumentacioni mbi provat dhe materialet e procedimit disiplinor të nëpunësit *****” të Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Procesverbali i seancës dëgjimore nr. 3936/9 datë 02.08.2021, “Për shtyerjen e seancës dëgjimore”, të Komisionit të Disiplinës;*
- *Aktin nr. 3936/10 prot., datë 04.08.2021, “Vendim i ndërmjetëm për zgjatjen e afatit të shqyrtimit deri në datën 31.08.2021”, të Komisionit të Disiplinës;*
- *Aktin nr. 3936/11 prot, datë 23.08.2021, “Relacion shtesë mbi procedurën e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit *****” të Drejtorit të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit;*
- *Aktin nr. 3936/12 prot., datë 25.08.2021, “Observacion ndaj shkresës nr.3936/11 prot., datë 23.08.2021, “Relacion shtesë mbi procedurën e ndaj nëpunësit *****” të ankuesit;*
- *Procesverbali i seancës dëgjimore nr. 3936/13 datë 27.08.2021, “Për seancën dëgjimore për procedimin disiplinor të nëpunësit *****”, të Komisionit të Disiplinës si dhe Vendimin (nr.3936/14 prot.) datë 20.09.2021, të Komisionit të Disiplinës.*

Nga shqyrtimi dokumentacionit të lartpërmendur konstatohet se:

Drejtori i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në cilësinë e eprorit direkt të nëpunësit ***** , ka iniciuar me kërkesë të tij, një proces disiplinor ndaj këtij të fundit, pasi ka konstatuar disa shkelje në kryerjen e detyrave të cilat konsistojnë kyesisht, me mos përmbushjen e detyrave funksionale të ankuesit dhe mosrespektimin e përsëritur të afateve të caktuara, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda për punën e institucionit, shkelje këto të parashikuara prej nenit 57, pika 2/a dhe 2/b, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Në këtë kuadër, eprori direkt, me aktin nr. 3936 prot., datë 08.06.2021, “Kërkesë për nisje të ecurisë disiplinore ndaj *****”, referuar neneve 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kërkesë në të cilën shpreh nevojën për ngritjen e Komisionit Disiplinor dhe nisjen e ecurisë disiplinore, me pretendimin se nëpunësi ***** , ka kryer disa shkelje, të cilat kanë sjellë pengesa dhe pasoja në mbarëvajtjen e proceseve të punës, si në produktin e kërkuar, ashtu edhe në afatet e vendosura dhe konkretisht referuar ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Këto shkelje konsistojnë sidomos:

- Mospërmbushje e rëndë e detyrave funksionale;
- Mosrespektim i përsëritur i afateve të caktuara, në përmbushjen e këtyre detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;
- Tejkallim i kompetencave dhe moszbatim i urdhrave të eprorëve;
- Hartim i materialeve të punës me gabime, etj.

Mbi bazën e kërkesës së mësipërme, me shkresën nr. 3936/1 prot., datë 15.06.2021, “Njoftim për fillim të ecurisë disiplinore për *****”, ankuesi është njoftuar se ndaj tij ka nisur një ecuri disiplinore për kryerje të “shkeljeve shumë të rënda” të shoqëruara më pasoja të rënda për institucionin.

Në vijim, me Urdhrin nr. 149, datë 17.06.2021 (nr. 3936/2 prot., datë 17.06.2021), “Për ngritjen e Komisionit të Disiplinor për shqyrtimin të një ecurie disiplinore, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”, të Sekretarit të Përgjithshëm, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është urdhëruar ngritja e Komisionit të Disiplinës për shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara nga eprori direkt i nëpunësit *****.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 3936/3 prot., datë 17.06.2021, “*Kërkesë për caktim të anëtarit nga DAP, në Komisionin e Disiplinës*”, të Sekretarit të Përgjithshëm, është kërkuar caktimi i një përfaqësuesi ligjor nga Departamenti i Administratës Publike. Nëpërmjet autorizimit me nr. 3808 prot., datë 24.06.2021, është caktuar përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, i cili do të ishte pjesë e Komisionit Disiplinor.

Ankuesi, pasi është njohur me shkresën nr. 3936/1 prot., datë 15.06.2021 “*Njoftim për fillim të ecurisë disiplinore*”, ka paraqitur pranë Drejtorit të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, kundërshtimet e tij (prorokolluar me nr. 3936/4 prot., datë 21.06.2021), me titull “*Observacion ndaj shkresës nr. 3936/1 prot, datë 15.06.2021 “Njoftim për fillim të ecurisë disiplinore” për ******”.

Në vijim, të situatës së krijuar, me shkresën nr. 3936/5 prot., datë 22.06.2021, “*Njoftim për shtyrjen e seancës mbi ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit ******”, të Sekretarit të Përgjithshëm, është njoftuar se seanca dëgjimore e caktuar për në datën 23.06.2021, do të shtyhet për arsye të pamundësisë për të qenë prezent, Drejtori i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, i cili siç është përmendur dhe më sipër është eprori direkt i ankuesit. Sipas këtij njoftimit seanca e radhës u caktua në datën 30.06.2021.

Në seancën dëgjimore zhvilluar në datën 30.06.2021, (ora 11:00), nëpunësi në procedim është paraqitur dhe seanca e shqyrtimit të çështjes disiplinore është zhvilluar rregullisht, me dakortësinë e palëve, (kjo provohet me, procesverbalin nr.30/6, datë 30.06.2021).

Në përfundim të diskutimeve, pas analizës së dokumentacionit, shqyrtimit të provave dhe pretendimeve të ngritura nga nëpunësi *****, eprori direkt i ankuesit, me aktin nr. 3936/6 prot, datë 06.07.2021, “*Informacion shtesë, të nevojshme për ecurinë disiplinore ndaj ******”, i është drejtuar Komisionit të Disiplinës, duke argumentuar se gjatë seancës dëgjimore zhvilluar në datën 30.06.2021, ka evidentuar shkelje të reja të nëpunësit të cilat duhet të merren parasysh nga ky Komisioni i Disiplinës.

Ankuesi, pasi është njohur me kërkesën e eprorit të tij, për shtim të objektit në aspektin e parashtrimit të shkeljeve të tjera të disiplinës, me shkresën e protokolluar me nr. 3936/7 prot, datë 08.07.2021, “*Kthim përgjigje shkresës nr.3936/6 prot, datë 06.07.2021, “Informacion shtesë, të nevojshme për ecurinë disiplinore ndaj ******”, ka parashtruar argumentat e tij, në lidhje me argumentet e reja të paraqitura nga eprori i tij.

Në vijim të kësaj gjendje të re të provave, Sekretari i Përgjithshëm, me aktin nr. 3936/8 prot., datë “*Dërgohet dokumentacioni mbi provat dhe materialet e procedimit disiplinor të*

*nëpunësit ******”, i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike dokumentacionin shtesë të ecurisë disiplinore, për të bërë përgatitjet e duhura për seancën e datës 02.08.2021.

Në seancën e rradhës (*provuar me, procesverbalin nr. 3936/9, datë 02.08.2021*), për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të ankuesit *******, anëtarët e Komisionit të Disiplinës, bazuar mbi kërkesën e eprorit direkt të nëpunësit, i cili ka vijuar të parashtrojë konstatimin e shkeljeve të reja nga ankuesi, kanë vendosur shtyrjen e seancës dëgjimore me qëllim njohjen me materialet e reja dhe njohjen me observacionet e paraqitura nga nëpunësi me aktin nr. 3936/7 prot, datë 08.07.2021, “*Kthim përgjigje shkresës nr.3936/6 prot., datë 06.07.2021, “Informacion shtesë, të nevojshme për ecurinë disiplinore ndaj *****”*”.

Në seancën dëgjimore të datës 04.08.2021, me aktin nr. 3936/10 prot., datë 04.08.2021, “*Vendimit të Ndërmjetëm*”, të Komisionit të Disiplinës, është vendosur zgjatja e afatit të shqyrtimit të kësaj ecurie disiplinore deri në datë 31.08.2021, me arsyetimin se një pjesë e anëtarëve të Komisionit si dhe vetë nëpunësi nuk do mund të ishin prezent, pasi për gjatë kësaj periudhe kishin parashikuar lejen e tyre vjetore.

Ndërkaq, me aktin nr. 3936/11 prot, datë 23.08.2021, “*Relacion shtese mbi procedurën e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit ******” të Drejtorit të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, janë parashtruar faktet e reja, që sipas tij duhet të mbaheshin parasysht nga Komisioni i Disiplinës, ndaj të cilave nëpunësi në fjalë, me shkresën e protokolluar nr. 3936/12 prot., datë 25.08.2021, “*Observacion ndaj shkresës nr. 3936/11 prot., datë 23.08.2021, “Relacion shtesë mbi procedurën e ndaj nëpunësit *****”*”, ka depozituar pretendimet e tij, duke kundërshtuar këto fakte.

Në përfundim të diskutimeve, pas analizës së dokumentacionit, shqyrtimit të provave dhe pretendimeve të ngritura nga nëpunësi *******, si dhe nga eprori i tij, me vendimin nr. 3936/14 prot., datë 20.09.2021, (*Shih procesverbalin e seancës dëgjimore nr.3936/13 datë 27.08.2021, “Për seancën dëgjimore për procedimin disiplinor të nëpunësit *****”*), të Komisionit të Disiplinës, mbështetur në pikën 3, germa “a”, “c” dhe “ç”, të nenit 57, “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”; në germën “b”, dhe “c” të nenit 58, “*Llojet e masave disiplinore*” dhe në pikën 2, të nenit 59, “*Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore*” në pikën 2, të nenit 60, pika 1, në germën “a”, dhe germën “b”, si dhe pika 2 dhe pika 4, “*Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, Komisioni i Disiplinës, ka vlerësuar se nëpunësi ka kryer shkelje të rënda disiplinore si: a) mospërbushja e detyrave; c) shkelje e përsëritur e rregullave të etikës në shërbimin civil; ç) sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me

*eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun, dhe në përfundim ka vendosur, marrjen e masës disiplinore: “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vjeçare, për nëpunësin civil *****, me detyrë Specialist në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimin e Mbetjeve, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”.*

Si përfundim, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilat materializohet procedura disiplinore, arrihet në konkluzionin se, nga pikëpamja procedurale janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni për këtë fakt të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, dëgjimin e thëniesve të tij dhe administrimin e provave materiale të nevojshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar (nr. 3936/14 prot., datë 20.09.2021) nga ana e Komisionit të Disiplinës, gjë e cila do të thotë se nga pikpamja e menaxhimit të këtij rasti nga ana e njësisë përgjegjëse dhe organizmave të tjera, janë zbatuar gjithë kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Përsa i përket trajtimit të përmbajtjes së procedimit të mësipërm disiplinor, pas konstatimit të faktit që nëpunësi *****, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në lidhje me këtë mosmarrëveshje, me padinë me objekt “Shfuqizim vendimi”, regjistruar me nr. 4260, datë 12.10.2021, me palë të paditura, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Departamentin e Administratës Publike, Komisioneri në zbatim të parimit të përcaktuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, çmon të mos shprehet meqënëse mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neneve 54 e 55, pikave “d” dhe “dh” të nenit 109 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procedimit disiplinor zhvilluar ndaj nëpunësit civil ***** me detyrë *“Specialist në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimin e Mbetjeve”*, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, përfunduar me marrjen e masës disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vjeçare”*, të Komisionit të Disiplinës dhe meqënëse nga pikpamja e menaxhimit të shërbimit civil në këtë rast, nuk konstatohen shkelje, të bëhet arkivimi i çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha